

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6063
E mërkurë, 15 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi vazhdon
intervistimin në Speciale
edhe të mërkurën FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SEANCA PLENARE PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË COVID-19 KA PËRFUNDUAR
TË MARTËN PA NDONJË REZULTAT FAQE 4-5

DEPUTETËT, PIKË E PESË SA I PËRKET MENAXHIMIT TË PANDEMISË COVID-19

Deputetët e grupeve të ndryshme parlamentare kanë shfaqur të martën pikëpamjet e tyre për gjendjen në vend sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19, e kanë kritikuar qeverinë Hoti, por edhe kanë dhënë ide dhe alternativa për menaxhimin e kësaj pandemie. Por, shkak i mungesës së deputetëve në sallën e Kuvendit është pamundësuar procesi i votimit të dy rezolutave, pas diskutimit për situatën pandemike. Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kryesia e Kuvendit do të vendosë që këto projektrezoluta të hidhen në votim në një nga seancat e ardhshme. Osmani ka thënë se vendit i duhet një bazë ligjore për luftimin e pandemisë, derisa ka kërkuar nga deputetët të mos bëhen arsye që ky virus të mos luftohet me ligj



OPINION

**NË EVROPË NUK DUHET
FOLUR MË PËR SHOQIPTARËT
ME GJUHËN E SERBISË (7) F. 11**

Shkruan:
Kudusi LAMA



**GJYKATA SPECIALE ME
PADREJTËSINË E VET ËSHTË
GJYKATË ETNIKE DHE SFIDON
KOSOVËN F. 8**



Shkruan: Nait HASANI

AKTUALE

**VUÇIQI TAKON PËRFAQËSUES TË
LUGINËS SË PRESHEVËS PËR
KONSULTIME RRETH QEVERISË F. 7**

**SPITALI I VUSHTRRISË
SHNDËRROHET NË SPITAL PËR
PACIENTËT ME COVID-19 F. 6**

EKONOMI

**TELEKOMI KËRKON NDIHMËN E
QEVERISË DHE TË PROKURORISË
NË RASTIN ME 'Z-MOBILE' F. 9**

SPORT

**MARMARINOS: TË GJITHË DO TË
KRENOHEN ME KOSOVËN F. 16**



QEVERIA SHQYRTON PROJEKTLIGJIN PËR MBROJTJEN E VLERAVE TË LUFTËS SË UÇK-së

Në mbledhjen e së martës, Qeveria e Kosovës ka dhënë mendimin për nismën legislative për Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shprehur përkrahjen e saj

për projektligjin dhe ka theksuar se miratimi i tij do ta kompletojë infrastrukturën ligjore për mbrojtjen dhe respektimin e vlerave të luftës, sakrificën, angazhimin dhe kontributin e UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës FAQE 7

Krijohet baza ligjore për testime të Covid-19 në institucionet private

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiçi takon përfaqësues të Luginës së Preshevës për konsultime rreth qeverisë

BEOGRAD, 14 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, bisedoi të martën me përfaqësues të listës zgjedhore "Alternativa Demokratike Shqiptare - Lugina e Bashkuar". Këto janë konsultimet e para të Vuçiçit për formimin e qeverisë, pas zgjedhjeve të 21 qershorit.

Në një njoftim të publikuar në uebfaqen e presidentit të Serbisë, thuhet se Vuçiçi "i dëgjoi propozimet, kërkesat dhe nevojat" e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës, të cilët për herë të parë në tri dekadat e fundit kanë marrë pjesë me një listë të përbashkët në zgjedhjet parlamentare të Serbisë. "Përfaqësuesit e partive



shqiptare kanë folur për qëllimin që shqiptarët të integrohen sa më shumë në institucionet e shtetit të Serbisë, si dhe për domosdoshmërinë e përpërimit ekonomik, si në jug të Serbisë, ashtu edhe në të gjithë vendin", thuhet në njoftimin e Presidencës serbe. Vuçiçi citohet të ketë thënë se është i gatshëm që në mënyra

të ndryshme "ta ndihmojë zhvillimin e jugut të Serbisë". Ai tha se do t'i informojë përfaqësuesit e partive shqiptare në 14 ditët e ardhshme për rrjedhën e mëtejshme të formimit të Qeverisë së Serbisë.

Shaip Kamberi, nga Partia për Veprim Demokratik në Bujanoc, i cili mori pjesë në takim me Vuçiçin, tha se vendimi i përfaqësuesve të Luginës rreth qëndrimit ndaj qeverisë së re "do të varet nga qëndrimi dhe programi që kjo qeveri do të ketë ndaj shqiptarëve dhe kërkesave të tyre legjitime". "Me presidentin e Republikës së Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, në cilësinë e

deputetëve të listës shqiptare, biseduam për nevojat e domosdoshme të popullsisë shqiptare, të cilat me dekada po injorohen", ka shkruar Kamberi në llogarinë e vet në "Facebook".

Më 5 korrik, Komisioni Zgjedhor në Serbi publikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 21 qershorit, në bazë të të cilave "Alternativa Demokratike Shqiptare - Lugina e Bashkuar" ka fituar tre mandate për deputetë.

Vuçiçi ka fituar mbi 60 për qind të votave në këto zgjedhje, që janë bojkotuar nga një pjesë e opozitës në Serbi. Ai do t'i vazhdojë konsultimet me partitë e tjera gjatë kësaj jave.

Sot dita kryesore e votimit të zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 14 KORRIK - Në Maqedoninë e Veriut të martën është zhvilluar dita e dytë e votimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare.

Të martën kanë votuar personat që vuajnë nga sëmundje të ndryshme, të moshuarit që nuk mund të dalin në qendrat e votimit, si dhe të burgosurit.

Kjo kategori përfshin 8 855 persona në zona të ndryshme të këtij vendi.

Ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, Venko Filipçe, tha se qytetarët nuk duhet të kenë frikë, pasi ekipe të specializuara mjekësh janë pranë votuesve, sikur që do të jenë edhe në ditën kryesore të votimit, të mërkurën.

Të hënën në Maqedoninë e Veriut kanë votuar personat e sëmurë me sëmundjen që e shkakton koronavirusi, Covid-19, si dhe ata që ndodhen në vetizolim dhe karantinë për shkak të kontakteve që kanë pasur me të infektuar.

Nga 759 të paraqitur për të votuar, të drejtën e votës e kanë



shfrytëzuar 723 persona. Për ta frenuar përhapjen e koronavirusit, zgjedhjet të mërkurën do të zhvillohen në bazë të protokollove të veçanta, me mbajtjen e maskave dhe të distancës fizike, si dhe me dezinfektimin dhe ajrosjen e hapësirave.

Të drejtë vote kanë rreth 1.8 milion persona.

Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut zhvillohen në gjashtë njësi zgjedhore dhe në secilën prej tyre zgjidhen nga 20 deputetë, apo në total 120 sa numëron Kuvendi i Maqedonisë së Veriut. Për të siguruar ulëse në Kuvend, në garë janë 15 parti politike dhe koalicionet, me gjithsej 1 578 kandidatë.

Haradinaj u bënë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të dalin masivisht në zgjedhje

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, u ka bërë thirrje shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut që të dalin masivisht në zgjedhje. "Nesër qytetarët e Maqedonisë së Veriut do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Fillimisht uroj që zgjedhjet të kalojnë në qetësi dhe mbi të gjitha, të fitojë demokracia. Po ashtu, bëj thirrje për të gjithë shqiptarët, që nesër të dalin masivisht në zgjedhje dhe të votojnë për ata që më së miri i përfaqësojnë interesat e tyre. Apeloj te liderët që do ta marrin besimin e shqiptarëve, që pas zgjedhjeve t'i tejkalojnë



ndasitë e tyre dhe të bëhen bashkë në qeverisjen e vendit", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kosova e përkushtuar që ta avancojë partneritetin me Finlandën

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ministri e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, në kuadër të takimeve virtuale ka zhvilluar të martën një video-konferencë me ambasadorin e Finlandës në Republikën e Kosovës, Pia Stjernvall.

Ajo me këtë rast ka falënderuar

ambasadorin e Finlandës për kontributin e vazhdueshëm që shteti i saj e ka dhënë për shtetndërtimin e Kosovës. "Finlanda është ndër vendet e para që e ka njohur dhe ndihmuar pavarësinë e Kosovës, duke vazhduar mbështetjen në shtetndërtim dhe në proceset integruese

evropiane. Pata kënaqësinë që sot t'i shpreh falënderimin e përzemërt ambasadores së Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, duke shprehur përkushtimin e palëkundur që partneriteti ynë, të avancojë në fusha me interes të dyanshëm", ka thënë ministri Haradinaj-Stublla.



Thaçi vazhdon intervistimin në Speciale edhe të mërkurën



HAGË, 14 KORRIK (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe të martën është paraqitur në Zyrën e Prokurorisë së Specializuar në Hagë, ku intervistimi i tij edhe në ditën e dytë zgjati rreth gjashtë orë. Presidenti Thaçi të martën është larguar nga objekti i

Speciales pa deklaruar asgjë për media, por gazetarët që janë të pranishëm atje kanë bërë me dije se intervistimi i tij do të vazhdojë edhe të mërkurën në të njëjtin orar, në orën 13:00. Presidenti Thaçi, një ditë më parë, pra të hënën, në Zyrën e Prokurorisë së Specializuar në

Hagë ka qëndruar mbi gjashtë orë, e pas daljes nga ajo ka bërë me dije se ka dëgjuar shkëmbimet e teknikaliteteve të ndryshme në mes të avokatit Prosper dhe prokurorëve, të çështjeve sqaruese teknike dhe në të njëjtën kohë edhe ato fillestare, të interesimit të

prokurorëve për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Para se të hynte në ndërtesën e Prokurorisë së Specializuar për intervistim, Thaçi ka thënë për mediat se beson se nga kjo sfidë do të dalë me sukses. "Sot jam këtu për ta respektuar atë që kam ëndërruar dhe për të cilën

kam luftuar. Një Kosovë e lirë e pavarur e bazuar në të drejta të barabarta, shoqëri multietnike dhe sundim i ligjit. Jam i gatshëm të përballem me sfidën e re dhe të ngadhënjej për djalin tim, familjen time, njerëzit e mi dhe shtetin tim. Asnjëri nuk mund ta rishkruajë historinë. Ky është çmimi për liri", ka thënë Thaçi para gazetarëve teksa dëgjohehin brohoritjet "UÇK, UÇK" dhe "Thaçi, Thaçi" të dhjetëra protestuesve shqiptarë që protestonin para Speciales kundër ngritjes së aktakuzës ndaj tij.

Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar se më 24 prill u ka dërguar Dhomave të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën presidenti Thaçi, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe të tjerë, akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte. Presidenti Thaçi më herët ka deklaruar se do të japë dorëheqje nga posti i presidentit nëse aktakuza ndaj tij konfirmohet. Gjykatësi i procedurës paraprake ka maksimum gjashtë muaj, nga muaji prill, për t'i konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzat.

Abrashi paralajmëron se së shpejti do të bëhet rishikimi i strategjisë rrugore

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka thënë se aksidentet në komunikacionin rrugor paraqiten si problem multidisiplinar, rrjedhimisht edhe përballja me këtë problem kërkon angazhim të të gjithëve. Ai ka paralajmëruar se së shpejti do të bëhet rishikimi i strategjisë rrugore 2016-2020. Ndërkaq, drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se kanë bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe ka theksuar se do t'i ngrehin kapacitetet për eliminimin e rreziqeve në komunikacion



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka publikuar raportin "Dekada e sigurisë rrugore 2010-2019", në të cilin janë publikuar të dhënat përgjatë këtyre viteve të aksidenteve në komunikacion. Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka thënë se aksidentet në komunikacionin rrugor paraqiten si problem multidisiplinar, rrjedhimisht edhe përballja me këtë problem kërkon angazhim të të gjithëve

dhe vetëm në këtë mënyrë mund të kemi sukses në uljen e aksidenteve. Ai ka përmendur edhe hapat të cilët planifikohet të ndërmerren në dobi të përmirësimit të sigurisë rrugore. "Shpejt do ta bëjmë rishikimin e strategjisë rrugore 2016-2020, apo draftimin e strategjisë së re. Do të nisim me zbatimin e planit të grupit punues për t'i identifikuar akset rrugore më të rrezikshme, sidomos atyre me fatalitet dhe do të fillojmë me kampanjë vetëdijesuese. Më shumë siguri në rrugë, më shumë jetë të shpëtuar", ka

thënë Abrashi. Ministri Abrashi ka theksuar se do ta ketë në prioritet shpëtimin e jetëve në komunikacion, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës. Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka thënë se ngritja e sigurisë ka avancuar nga viti në vit, por çdoherë duke marrë parasysh faktin se siguria në rrugë asnjëherë nuk është e mjaftueshme. "Siguria në rrugë ende kërkon vëmendje të

institucioneve tona", është shprehur ministri Veliu. Edhe drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka prezantuar masat që janë marrë në komunikacion, duke theksuar se janë duke punuar për t'i ndërgjegjësuar pjesëmarrësit në komunikacion. Ai ka thënë se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe do t'i ngrehin kapacitetet për eliminimin e rreziqeve në komunikacion. "Dekada e sigurisë rrugore

2010-2019", përpiluar nga Këshilli Koordinues i Sigurisë Rrugore në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, paraqet statistikën e numrit të aksidenteve të ndara sipas llojeve dhe viteve dhe aktivitetet kryesore për siguri në rrugë. Ndërkaq "Gjendja e sigurisë në trafikun rrugor", prezantuar nga Policia e Kosovës, pasqyroi në detaje gjendjen aktuale të sigurisë në trafikun rrugor, si dhe planet dhe strategjitë efektive të cilat kontribuojnë në uljen e numrit të aksidenteve në trafik.

SEANCA PLENARE PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË COVID-19 KA PËRFUNDUAR TË MARTËN PA NDONJË REZULTAT

DEPUTETËT, PIKË E PESË SA I PËRKET MENAXHIMIT TË PANDEMISË COVID-19



Deputetët e grupeve të ndryshme parlamentare kanë shfaqur të martën pikëpamjet e tyre për gjendjen në vend sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19, e kanë kritikuar qeverinë Hoti, por edhe kanë dhënë ide dhe alternativa për menaxhimin e kësaj pandemie. Por, shkak i mungesës së deputetëve në sallën e Kuvendit është pamundësuar procesi i votimit të dy rezolutave, pas diskutimit për situatën pandemike. Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kryesia e Kuvendit do të vendosë që këto projektrezoluta të hidhen në votim në një nga seancat e ardhshme. Osmani ka thënë se vendit i duhet një bazë ligjore për luftimin e pandemisë, derisa ka kërkuar nga deputetët të mos bëhen arsye që ky virus të mos luftohet me ligj

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINE, 14 KORRIK - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vazhduar të martën seancën plenare rreth raportimit të kryeministrit dhe debatin parlamentar lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid-19. Deputetët e grupeve të ndryshme parlamentare kanë shfaqur pikëpamjet e tyre për gjendjen në vend sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19, e kanë kritikuar qeverinë Hoti, por edhe kanë dhënë ide dhe alternativa për menaxhimin e kësaj pandemie. Pas përmbylljes së debatit parlamentar, deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ka lexuar tekstin e projekt-rezolutës për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Po ashtu, edhe Bekim Haxhiu në emër të grupit parlamentar të PDK-së ka propozuar për votim një projekt-rezolutë për të njëjtën çështje. Mirëpo, në mungesë të kuorumit, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kryesia e Kuvendit do të vendosë që këto projekt-rezoluta të hidhen në votim në një nga seancat e ardhshme. Por, Osmani ka thënë se paraprakisht do të ishte mirë që grupet parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet në mënyrë që Kuvendi ta miratojë vetëm një projekt-rezolutë për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Kryeparlamentarja Vjosa Osmani ka përtëritur se vendit i duhet një bazë ligjore për luftimin e pandemisë, derisa ka kërkuar nga deputetët të mos bëhen arsye që ky virus të mos luftohet me ligj. Ajo ka thënë se

nuk ka asgjë politike në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese për dallim prej asaj që po e thotë zëvendëskryemi-

nistri Driton Selmanaj. "Shpresoj që shumë shpejt ky projektligji të vijë në Kuvend për lexim të parë dhe ta marrë votën tuaj. Mirëpo, mos thoni se kjo është iniciuar për arsye politike. Nuk ka asgjë politike në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese. E ka sqaruar shumë mirë, për dallim prej asaj që po tenton ta thotë një nga zëvendëskryeministrat. Gjykata thotë se për të bërë kufizime për të drejtat e njeriut, sikur këto që janë të nevojshme këto ditë, nuk duhet gjendje e jashtëzakonshme, por mjafton një ligj sipas nenit 55 të Kushtetutës. Asnjëri nuk kemi të drejtë ta bllokojmë një mundësi që të luftohet pan-

demia. Dhe kjo arrihet nëpërmjet këtij ligji", ka thënë Osmani. Deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se ligji për pandeminë nuk është miratuar për shkak të mosmarrëveshjeve politike në mes të LV-së dhe LDK-së. Krasniqi, duke i reaguar Vjosa Osmanit, e cila i ka akuzuar deputetët se për inate politike nuk e kanë përkrahur iniciativën për ligjin anti-Covid, ka rikujtuar se PDK-ja ka kërkuar që me urgjencë të miratohet ky ligj. "Të jemi më specifikë se kush e ka penguar këtë ligj. Grupi Parlamentar i PDK-së e ka mbështetur prej fillimit një iniciativë të tillë. Mosmarrëveshjet e LV-së me

PDK-ja kërkon vendim urgjent për rritjen e pagave për profesionistët shëndetësorë

Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar urgjentisht që Qeveria e Kosovës të marrë vendim për rritjen e pagave për profesionistët shëndetësorë ashtu siç janë të planifikuara me Projektligjin e Pagave. Deputeti nga radhët e kësaj partie, Bekim Haxhiu, ka thënë se ky vendim duhet t'i përfshijë të gjithë zyrtarët shtetërorë që po përballen çdo ditë me menaxhimin e pan-

demisë Covid-19. "Urgjentisht kërkojmë që Qeveria e Kosovës me vendim të veçantë t'i rrisë pagat e profesionistëve shëndetësorë ashtu siç janë të planifikuara me Projektligjin e Pagave, duke përfshirë edhe rritjen e pagave sipas kërkesave të infermierëve. Po ashtu, ky vendim duhet t'i përfshijë të gjithë zyrtarët shtetërorë që po përballen çdo ditë me menax-

himin e pandemisë Covid-19", ka deklaruar Haxhiu. Sipas tij, Ministria e Shëndetësisë duhet ta mundësojë punësimin e 1 500 profesionistëve të tjerë shëndetësorë me qëllim të përballjes me pandeminë. "Ministria e Shëndetësisë duhet ta mundësojë punësimin e 1 500 profesionistëve shëndetësorë me qëllim të përballjes me pandeminë", ka thënë Haxhiu.

LDK-në nuk kanë lënë për të lëvizur. Zotëri Hamza dhe ne kemi kërkuar që të vazhdohet iniciativa. Është e vërtetë që kjo është penguar për shkak të mosmarrëveshjeve politike, por jo prej anës së PDK-së”, ka thënë Krasniqi.

Në emër të grupit parlamentar të LDK-së ka folur Ekrem Hyseni, i cili ka thënë se shtimi i numrit të rasteve pozitive ka ndodhur pas hapjes dhe lirimit të masave. “Numri i rasteve të reja, krahasuar me kohën e izolimit total, normalisht se është më i madh. Si mund ta krahasojmë sot numrin e rasteve të reja kur funksionojnë ekonomia, aeroporti, kur kufijtë janë të hapur, me një kohë kur njerëzit kanë qenë të izoluar në shtëpitë e tyre dhe gjurmimi i rasteve ka qenë shumë më i thjeshtë, kurse numri i testeve shumë më i vogël, si dhe kontakti i qytetarëve ka qenë shumë më i vogël”, ka thënë Hyseni, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës të sigurojë maska për qytetarët, qoftë edhe me kosto të ulët, ndërsa nga organet e zbatimit të masave që të jenë sa më aktive në terren.

Për pandeminë Covid-19 në vend, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ka folur Fatmire Mulhaxha-Kollçaku. Ajo e ka kritikuar qeverinë Hoti për menaxhimin e pandemisë Covid-19. “Ne tashmë jeni në rrethana krejt të tjera. Fatkeqësisht, edhe për këtë dikush duhet ta marrë përgjegjësinë. Pra, jemi në rrethana ku radhitemi si vendi me rrezikshmëri më të lartë, një vend që nuk preferohet për vizitë nga qytetarët e vendeve të Bashkimit Evropian”, ka thënë Kollçaku, duke shtuar se Kosova nën qeverisjen Kurti ishte ndër tri vendet me menaxhimin më të mirë, kurse tani është një nga vendet me menaxhimin më të keq të pandemisë Covid-19. Ajo e ka akuzuar qeverinë Hoti që për inate personale nuk e ka votuar projektligjin kundër Covid-19. Rreth situatës për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ka folur edhe deputeti i AAK-së, Shkumbin Demaliaj, i cili ka thënë se me pandeminë nuk duhet të bëhet politikë që, sipas tij, po ndodh aktualisht. Ai për këtë e ka kritikuar kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani dhe deputetët e LV-së. “Deputetët e LV-së thonë e rrëzuan qeverinë më të mirë. Juve ju duket ashtu. Unë nuk ju shoh opozitë ilegale, sikur që ju i thoni kësaj qeverie ilegale”, ka thënë ai.

Në 24 orët e fundit Demaliaj ka thënë se Covid-19 është shndërruar në çështje politike duke përmendur edhe deklaratën e Zemajt, i cili kishte thënë se s’ka gjetur një plan kundër pandemisë nga qeveria paraprake.

Krijohet baza ligjore për testime të Covid-19 në institucionet private

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar udhëzimet administrative nëpërmjet të cilave edhe institucioneve shëndetësore private u lejohet të kryejnë testime për Covid-19. Institucionet private shëndetësore që aplikojnë për licencim duhet të plotësojnë një sërë kushtesh që janë përcaktuar në bazë të udhëzimeve administrative

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar udhëzimet administrative nëpërmjet të cilave u lejohet edhe institucioneve shëndetësore private të kryejnë testime për Covid-19. “Udhëzimet përcaktojnë llojin e institucioneve që mund ta ofrojnë këtë lloj të testimit, kushtet që duhet t’i ofrojnë ato, përfshirë hapësirën, pajisjet, llojet e testeve si dhe raportimi i tyre në baza ditore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Duke qenë që me këto udhëzime, përveç testeve molekulare për detektim të acideve nukleike të SARS -Cov-2 që kryhen në laboratorët mjekësorë të Mikrobiologjisë Klinike, lejohen të kryhen edhe testet serologjike (për detektim të antitropave të SARS-COV-2; teste të shpejta që detektojnë antigjenin e SARS-Cov-2 dhe teste të shpejta që detektojnë antitropat kundër SARS-Cov-2”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë, Faik Hoti, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se institucionet private që aplikojnë për licencim duhet të plotësojnë një sërë kushtesh që janë përcaktuar në bazë të udhëzimeve administrative.

Më herët ishte raportuar se institucioneve private nuk do t’u lejohet ta kryejnë testin PCR i cili përcakton saktë se a ekziston virusi në trup dhe bazohet në



analizën e mostrave të strishos në hundë. Mirëpo, zëdhënësi Hoti ka thënë se nëse laboratorët privatë kanë aparaturat e nevo-

jshme dhe përmbushin kushtet për testime të tilla, atëherë do të lejohen t’i kryejnë ato.

Ndërsa testin serologjik, atë që

përcakton antitropat të një person, nuk e bën aktualisht as Institutin Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Mikrobiologu nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, Lul Raka, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se të gjitha testet duhet ta kenë vulën e Agjencisë Evropiane të Barnave. Pacientët e shëruar nga Covid-19 supozohet se janë imunë ndaj koronavirusit. Gjithnjë e më shumë vende në botë janë duke u kushtuar rëndësi testeve serologjike, të cilat pasqyrojnë imunitetin e popullatës dhe rrjedhimisht do të ndikojnë edhe në lehtësimin e masave kufizuese të një vendi.

MSh-ja e ndryshon kohën e raportimit për situatën epidemiologjike

Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka njoftuar se nga data 15 korrik njoftimet për rastet e reja të të infektuarve dhe viktimave nga Covid-19 do të bëhen publike në orën 15:00. “Po në këtë komunikim, çdo ditë do të jepen edhe të dhënat për numrin e pacientëve të shtrirë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe njësitë e tij - spitalet e përgjithshme, gjendjen shëndetësore të pacientëve si dhe karakteristika të tjera me interes rreth ecurisë klinike të Covid-19 në Kosovë”, thuhet në komunikatën e Ministrisë së

Shëndetësisë. Deri më tani njoftimet e Institutit të Shëndetësisë Publike (IKShPK) janë shpallur çdo ditë në orët e vona të mbrëmjes. Ndërkohë IKShPK-ja ka bërë me dije se të martën në Laboratorin e Mikrobiologjisë molekulare janë duke u testuar rreth 400 mostra të marra për Covid-19. Këto rezultate të mostrave do të publikohen sot (e mërkurë). Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe shtatë spitalet e përgjithshme: Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Vushtrri janë të hospitalizuar 460

pacientë. “Prej tyre, 306 pacientë janë të konfirmuar me Covid-19, nga të cilët 217 pacientë janë me oksigjenoterapi dhe 11 të intubuar”, thuhet në njoftimin të Ministrisë së Shëndetësisë. Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, që nga regjistrimi i rasteve të para me koronavirus më 13 mars e deri më 13 korrik janë regjistruar në total 5 118 raste me Covid-19 në vendin tonë. Prej tyre, 111 pacientë kanë vdekur, 2 370 janë shëruar, ndërsa raste aktive vazhdojnë të jenë edhe 2 640.

Kuçi dhe Ahmeti vazhdojnë bashkëpunimin për kryeqytetin

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 PRISHTINË - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, është takuar të martën me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. Ministri Blerim Kuçi dhe kryetari Shpend Ahmeti kanë diskutuar një sërë temash, që kanë vënë fokus në funksionimin më të mirë në këtë periudhë të të gjitha shërbimeve publike që varen nga ndërmarrjet publike qendrore.

Ministri Kuçi e ka siguruar ekzekutivin e kryeqytetit se do t’i ketë në fokus këto shërbime publike dhe se bashkëpunimi do të jetë i përhershëm. “Të

gjitha marrëveshjet dhe memorandumet e mëhershme në mes të Komunës së Prishtinës dhe resorëve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit do të konsiderohen dhe ne jemi të gatshëm ta vazhdojmë bashkëpunimin. Prishtina është kryeqytet dhe ne e dimë rëndësinë e funksionimit të rregullt në kryeqytet. Këtu hyjnë edhe shërbimet publike që kryhen nga ndërmarrjet publike qendrore, që janë fushëveprimi i ministrisë sonë. E njëjta do të jetë edhe për temat e mjedisit apo edhe planifikimit hapësinor”, ka thënë ministri Blerim Kuçi.

Ndërsa kryetari Shpend Ahmeti ka vlerësuar një qasje të tillë të



bashkëpunimit nga ministri Kuçi, duke e falënderuar dhe u treguar i gatshëm për secilin bashkëpunim që ofrohet.

Në këtë takim është nënshkruar edhe një memorandum në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit që për 10 vjetët e

ardhshme do t’i sigurojë Komunës së Prishtinës një hapësirë për Pikën Informuese Turistike. Kjo pikë do të vendoset në një hapësirë përdhese të Ministrisë dhe Ekonomisë dhe do të ketë dalje në Sheshin “Zahir Pajaziti”.

Policia 'ruan' pacientët me koronavirus nga familjarët

PRISHTINË, 14 KORRIK - Autoritetet e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës kanë marrë masa për ta pamundësuar qasjen e familjarëve të personave të sëmurë nga Covid-19 si dhe individëve të tjerë të paautorizuar në klinikat ku këta të fundit po trajtohen. Pavarësisht që familjarëve të personave me Covid-19 u ndalohet qarkullimi i lirë jashtë shtëpive të tyre, për shkak se konsiderohen si persona të kontaktit të ngushtë me të infektuarin, në disa raste familjarët e tillë kanë gjetur mënyra për të hyrë brenda klinikave ku po trajtohen familjarët e tyre të infektuar. Këtë e konfirmojnë edhe zyrtarët e Shërbimit Spitalor të Klinikës Universitare të Kosovës (ShSKUK).

Për më shumë, sipas tyre, asnjë personi, që nuk i takon stafit shëndetësor që përkujdeset për këta pacientë, nuk i lejohet qasja në klinika si dhe kontakti me personat me koronavirus. Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se të gjithë qytetarët e vendit, e sidomos familjarët e personave të

infektuar me koronavirus dhe që janë duke marrë trajtim spitalor, kanë për obligim që t'i zbatojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore dhe të atyre qeveritare. "Ata nuk lejohet të dalin nga shtëpitë e tyre. Duhet të jenë të vetizoluar për shkak se janë raste të kontaktit. Pra, e kam fjalën për anëtarët e ngushtë të familjes. Pra, fillimisht ata duhet që të mos dalin nga shtëpitë e tyre. Ndërkohë që sigurimi fizik (në QKUK) i ka të gjitha kompetencat për ta ndaluar hyrjen e tyre. Fatkeqësisht, ndonjëherë ka edhe persona që gjejnë rrugë alternative për t'u qasur deri te klinikat dhe brenda tyre. Por, mendoj se është e vërtetë që ka ende vend për përmirësim për këtë çështje. Megjithatë, mendoj se tani është duke shkuar në atë drejtim dhe menaxherët e klinikave janë duke marrë masa që kjo mos të vazhdojë", ka thënë Krasniqi.

"Radio Evropa e Lirë" ka raportuar më 5 korrik për disa raste kur familjarët të pacientëve me sëmundjen Covid-19 kanë deklaruar se kanë qëndruar pranë të afërmeve të tyre gjatë mjekimit në QKUK.

Isme Humolli, zyrtarë për emergjenca e OBSH-së në



Kosovë, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", thotë se prania e familjarëve ose çdo individ që nuk është pjesë e stafit mjekësor në klinikat ku trajtohen pacientët me koronavirus, bie ndesh jo vetëm me rekomandimet e OBSH-së, por edhe me Ligjin për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse. Përpjekjet e individëve të caktuar për të hyrë brenda klinikave ku janë duke u trajtuar pacientët me koronavirus, kanë vazhduar, ndonëse jo me intensitetin e disa ditëve më parë.

Vizitave të palejuara në klinikat ku po trajtohen pacientët me Covid-19, në Klinikën Infektive, atë të Pulmologjisë dhe në Qendrën e Mjekësisë Sportive, i kanë shtyrë zyrtarët e ShSKUK-së që ta rrisin sigurinë fizike, në veçanti për këto klinika. Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ka thënë se tashmë për këtë kanë kërkuar edhe ndihmën e Policisë së Kosovës. "Kam kërkuar nga drejtorët (e klinikave) që t'i zbatojnë rregullat për sa i përket

moslejimit të familjarëve nëpër dhomat e pacientëve. Përveç kësaj, kam kërkuar në formë zyrtare dhe me shkrim edhe nga Policia e Kosovës. Për Klinikë Infektive ka qenë edhe më herët. Por, kam kërkuar që edhe Klinika e Pulmologjisë dhe Njësia Intensive e Qendrës së Mjekësisë Sportive të ndihmohen me një ekip mjekësor dhe me një ekip të policisë statike, 24 orë në ditë. Tashmë i kemi tri patrulla: një te Pulmologjia, një tek Infektivit dhe një te Mjekësia Sportive", ka bërë me dije Krasniqi.

Spitali i Vushtrrisë shndërrohet në spital për pacientët me Covid-19

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Komiteti për menaxhimin e pandemisë Covid-19 në Kosovë, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, ka vendosur të martën që Spitalin e Vushtrrisë ta shndërrojë tërësisht në spital për pacientët e sëmurë me Covid-19. Lajmin e ka bërë me dije Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. "Spitali i Vushtrrisë shumë shpejt do të pranojë pacientët nga qyteti i Mitrovicës dhe qyteti i Vushtrrisë dhe rrethinat që kanë. Pacientët që kanë nevojë për shërbime të tjera, të natyrës jo Covid-19, do t'i marrim në Spitalin e Mitrovicës. Ndërkohë, edhe personeli shëndetësor do të ristrukturohet në harmoni me këtë qëndrim", ka thënë Krasniqi në një konferencë për media.

Ai ka thënë se është marrë vendim që në kuadër të planifikimeve për shtim të numrit të shtretërve, një kat i

Klinikës së Neurologjisë në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me 60 shtretër, të vihet në dispozicion për trajtimin e pacientëve me Covid-19. Aktualisht, sipas Krasniqit, në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet rajonale janë duke u trajtuar rreth 450 pacientë me koronavirus.

Duke folur në të njëjtën konferencë për media, ministri i Shëndetësisë i Qeverisë së Kosovës, Armend Zemaj, ka thënë se nga sot Klinikës Infektive të QKUK-së i janë shtuar edhe 50 punëtorë të rinj shëndetësorë, me të cilët është planifikuar përfundimi i stafit mjekësor që trajton personat e sëmurë me Covid-19. "Bashkë me ne janë 50 profesionistë. Ndërkaq, tetë laborantë kanë filluar punën në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, katër biologë. Dje 20 inspektorë kanë filluar punën me ekipet monitoruese dhe zbatuese të ligjit. Sot gjatë ditës do të shpërndahen edhe 50 mjekë dhe 62 infermierë, sipas kërkesave dhe nevojave që janë akoma në rritje. Nuk do të thotë



që ne do të ndalemi me këtë angazhim", ka thënë Zemaj. Drejtoresha e Klinikës Infektive në QKUK, Lindita Ajazaj-Berisha, ka thënë se aktualisht në këtë klinikë janë të shtrirë 96 pacientë me Covid-19, 60 për qind e të cilëve janë duke u

trajtuar me oksigjenoterapi. "Në mjekimin intensiv janë pesë pacientë, të cilët janë në gjendje kritike", ka thënë Ajazaj-Berisha.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, që nga

regjistrimi i rasteve të para me koronavirus më 13 mars e deri më 13 korrik janë regjistruar në total 5 118 raste. Prej tyre, 108 pacientë kanë vdekur, 2 370 janë shëruar, ndërsa raste aktive vazhdojnë të jenë edhe 2 640.

Qeveria shqyrton Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

Në mbledhjen e së martës, Qeveria e Kosovës ka dhënë mendimin për nismën legislative për Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shprehur përkrahjen e saj për projektligjin dhe ka theksuar se miratimi i tij do ta kompletojë infrastrukturën ligjore për mbrojtjen dhe respektimin e vlerave të luftës, sakrificën, angazhimin dhe kontributin e UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës



është vlerë kristal e pastër - njëjtë si gjaku i dëshmorëve dhe liria që na lanë pas", ka shkruar ministrja Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në "Facebook". Po në këtë mbledhje të qeverisë është aprovuar dhe proceduar për në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe mendimi i

Qeverisë së Republikës së Kosovës për nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike. Në opinionin e Ministrisë së Financave për projektligjin në fjalë është theksuar se propozimet për ndryshimet ligjore përmbledhen në rregullat fiskale për rritjen e përkohshme të kufirit të deficitit në rrethanat e pandemisë Covid-19 dhe në ndryshimin e bilancit bankar. Ministria e Financave ka konstatuar se në dispozitat aktuale të ligjit, Kuvendi i Republikës së Kosovës tashmë ka bërë ndryshimet për tejkalimin e rregullave fiskale të deficitit dhe kufizimit të bilancit bankar. Andaj, edhe konsiderohet që ndryshimet e propozuara me këtë nismë legislative nuk janë të nevojshme. Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit 2020-2024. Ky program ka për qëllim përcaktimin e masave dhe të prioritetëve të institucioneve shtetërore për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Objektivi parësor i programit është përcaktimi i masave dhe prioritetëve që do ta mundësojnë përbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo

marrëveshje dhe konsiderohet si një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në rrugën për integrim në Bashkimin Evropian. Miratimin e kabinetit qeveritar e kanë marrë edhe tre vendime për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim për interes publik. Vendimi i parë ka të bëjë me objektet që menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit e të cilat preken nga realizimi i projekteve: ndërtimi i parkut të amfiteatrit në fshatin Mushtisht dhe çerdes së fëmijëve dhe këndit për të moshuarit në fshatin Studençan të Komunës së Suharekës. Vendimi i dytë për shpronësimin e pronës së paluajtshme, e cila preket nga restaurimi dhe konservimi i objektit "Shtabi i UÇK-së në Kosters", Komuna e Skenderajt. Ndërsa vendimi i tretë është për shpronësimin e pronave të paluajtshme private, të cilat preken nga ndërtimi i "Shiritit për rreshtim" për hyrje në Ambasadën Amerikane. Qeveria ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 71 269 euro për Komunën e Suharekës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në ekonominë bujqësore në këtë komunë.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 KORRIK - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar të martën mbledhjen e rregullt në të cilën janë miratuar disa vendime dhe politika të qeverisë në fusha të saj të përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me përfundimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka dhënë mendimin për nismën legislative për Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në opinionin për përputhshmërinë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, është thënë se dispozitat e kësaj fushe nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së dhe, si e tillë, mbetet në kompetencë të rregullimit të brendshëm për vendet e Bashkimit Evropian. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shprehur përkrahjen e saj për projektligjin dhe ka theksuar se miratimi i tij do ta kompletojë infrastrukturën ligjore për mbrojtjen dhe respektimin e vlerave të luftës, sakrificën, angazhimin dhe kontributin e UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë filli i lirisë prej ku ne mund të nxjerrim vendime e ligje sot. "Tri shkronjat e UÇK-së, para se t'i mbrojmë ne, ato kanë mbrojtur veten dhe kombin. Ne vetëm

mund t'u shërbejmë tash, me nderime të sinqerta, me lartësim e mbrojtje institucionale, siç e kemi obligim kombëtar e historik. Kabinetet qeveritare ndërrohen, legjislativët po ashtu, por ajo çfarë nuk ndërrohet është historia: Ushtria Çlirimtare e Kosovës është e ndritshmja e fundshkullit që shkoi dhe është bazamenti i së ardhmes së shtetit dhe e kombit që ne ëndërrojmë. UÇK-ja nuk është pjesë tavolinash e politikash, nuk është as debat për opinione, por

Agim Veliu emërohet koordinator kundër terrorizmit

Në mbledhjen e së martës, qeveria ka emëruar ministrin Agim Veliu, Koordinator Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimit të Terrorizmit. Me këtë vendim, ai do t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me çështjet e luftimit të terrorizmit dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë detyrë, koordinatori do ta këshillojë kryeministrin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e

terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin dhe do t'i koordinojë aktivitetet e të gjitha institucioneve relevante në çështjet e luftimit të terrorizmit dhe masave kundër ekstremizmit të dhunshëm. Koordinatorin Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimit të Terrorizmit do të jetë përgjegjës dhe pikë kontakti ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë koordinimin e organizimeve, donacioneve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare.

FSK-ja siguron se ka kapacitete mjekësore për t'u përballur me çdo situatë



PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të martën në takim komandantin e FSK-së, Rrahman Rama, me të cilin ka biseduar rreth ndihmës dhe gatishmërisë së FSK-së për të ndihmuar në masat për parandalimin e pandemisë Covid-19. "Gjenerali Rama sqaroi se FSK-ja ka kapacitete mjekë-

sore dhe logjistike për t'u përballur me çfarëdo situatë. Në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës është vënë në gjendje gatishmërie 'Batalioni i Mjekësisë', që mund të vihet plotësisht në shërbim të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Zemaj pas takimit, duke falënderuar gjeneral Ramën për bashkëpunimin e shkëlqyer, gatishmërinë e tij dhe FSK-së

dhe ndihmën që po ofrohet në betejën kundër virusit. Zemaj ka konfirmuar se Ministria e Shëndetësisë do ta përkrahë FSK-në për fuqizimin e personelit shëndetësor dhe me pajisje mjekësore. "Me ushtarët tanë, vajzat e djemtë FSK-së dhe së bashku me të gjithë qytetarët do të triumfojmë në luftën me pandeminë", ka thënë ministri Zemaj.

Gjykata Speciale me padrejtësinë e vet është gjykatë etnike dhe sfidon Kosovën

Shkruan: Nait HASANI

I dashur Hashim, shoku im president,
Armiku i shqiptarëve janë vetë shqiptarët, thotë Faik Konica. Ishim të ri, mësonim për historinë, historinë e popullit tonë nëpër shekuj dhe pas kaq kohe historia na përsëritej me ashpërsinë e saj, me luftën në tokën tonë të cinguar e të copëtuar skajshmërisht. Ishte viti 1993. Ishte verë. Ishte mbrëmje. Bëra telefon (në banesën e Ramadan Veliut) në Dragodan. Cingëroi telefoni një herë, dy herë, tri herë dhe u hap. U lajmërua një zë: Mirëmbërma. "Më duhet Dani (Ramadan Veliu)", - i thashë. "Nuk është këtu, - më tha. Kush po e kërkon?" "Naiti po e kërkon". "Po, unë jam Naiti". "Po shumë mirë". "Ju kush jeni?" "Jam Hashimi". "Ku po pimë kafe?" "Ku të duash. Te 'Roma'" (një kafene te Santeja atëherë ashtu quheshin, ato kafet aty kanë qenë vend ideale për çdo gjë) dhe pas disa minutave u takuam aty në kafene "Roma".

Shoku im Hashim,
Në atë kohë biseduam për rënien e shokëve nëpër burgje që i kishte arrestuar policia sekrete serbe apo UDB-a dhe ti ishe një nga ta që kërkohesh nga UDB-a. Biseduam për Xhavitin, Xhavit Hazirin, Bajrushin etj. (unë i njihja nga koha e burgjeve që ishim në vuajtje me një dhomë me Xhavitin dhe Bajrushin), për gjendjen e krijuar në Kosovë pas arrestimeve. Biseduam për gjendjen dhe mundësinë e riorganizimit të rezistencës sonë, për luftën që bëhej në Bosnje e Hercegovinë, për krimet e genocidit serb dhe Srebrenicën me tmerret e saj. Biseduam për frikën që kishin ngjallur të populli ynë, ato ngjarje në ish-Jugosllavi. Biseduam për gjendjen politike të ne, që ishte vendosur nga politika e asaj kohe në Kosovë, që populli ynë besonte patjetërsueshëm, që për kohën ishte një e arritur e madhe të mbaje nën kontroll një popull me pretekstin e hakmarrjes serbe. Biseduam për sfidat që na prisnin drejt lirisë.

Shoku im Hashim,
Ditët kalonin një nga një dhe ne përditë bëheshim më të përgjegjshëm me gjendjen politike. Gjykimi i grupit të Xhavitit më 1993 ishte fundi i politikës paqësore dhe fillimi i politikës aktive e ushtarake të LPK-së - Lëvizjes Popullore të Kosovës në Kosovë, që për ne idealistët që e donim lirinë me çdo çmim dhe të jetës sonë. Ne u takuam sa e sa herë, në rrethana ilegaliteti, duke u ruajtur nga Serbia e bashkëpunëtorët e saj. Ne arritëm ta ngrehnim në këmbë popullin me politikën tonë të drejtë çlirimtare.



Pas rënies sime në burg dhe gjykimit tonë me denik kapital, çdo kismë pushke, çdo fjalë në gazeta serbe (aty ku mund të lexonim e dëgjonim), na jepte shpirt, na mbante gjallë. Ngritja në shkallë vendi e UÇK-së në luftë për liritë i takojnë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe ty. Unë gëzohesha kur emrat e juaj dolën në skenën politike dhe ushtarake. Unë jetoja me ju. Isha në çdo betejë me ju. Në ato beteja ne i dhamë gjak lirisë së Kosovës, e bëmë të shenjtë atdheun e flamurin kuq e zi, e bëmë edhe më të kuqe, e vulosëm me gjakun e dëshmorëve të UÇK-së, që ranë në fushëbeteja anekënd Kosovës për çlirim kombëtar e pavarësi nga Serbia. Ne nuk ishim vetëm. Në luftën tonë kishim botën demokratike e lirisë me ne. Kishim faktorin politik ndërkombëtar me ne dhe mërgatën shqiptare, kudo anekënd globit, që erdhën dhe në luftë dhe nuk kursyen asgjë për atdhe. Konferenca e Rambujesë për Kosovën tregoi vlerat lirisë tonë, luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të drejtën tonë për shtet, për pavarësi dhe shkëputje nga Serbia. Aty ishit ju, vendimtarë ndër vendimtarët për të ardhmen e Kosovës dhe krijimin e aleancave me aleatët perëndimorë dhe me ShBA-në. Bombardimet 77-ditëshe nga NATO-ja, të Aleancës Veri Atlantike kundër Serbisë dhe kapitullimi i saj më 10 qershor në Kumanovë, ishte përmbyllje shekullore e luftës së popullit shqiptar në Kosovë për liri e pavarësi. 10 qershori 1878 ishte krijimi i Lidhjes së Prizrenit, ishte dita kur shqiptarët iu kundërvunë

copëtimit të tokave shqiptare nën Perandorinë Osmane nga fqinjët tanë serbët, malazezët, grekët e bullgarët. Kjo datë e riktheu Lidhjen e Prizrenit pas shekujsh në Kumanovë dhe unifikimin e kombit shqiptar. Të gjitha betejat i fituam, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me gjakun e Ademit e Jasharëve, me gjakun e Luanit e të Haradinajve, me gjakun e Zahirit e llapjanëve, me gjakun e Remzi Ademajt dhe prizrenasve, me gjakun e me këngët e pushkës së Mujës e Beqës, që i dhanë zë e dritë Kosovës me UÇK-në. Të gjitha këto armiku e armiqët nuk na falën bashkëluftëtari im, Hashim. Ne si UÇK i mundëm, por ata u hakmorën, djallëzisht si armiq të tërbuar nga humbjet. Ne u ekzaltuam nga fitorja dhe mbështetja e aleatëve. I injoruam ata, se Kosova ishte e jona, në dorën tonë dhe e kishim tonën, por ishim të rinj dhe i besonim miqve.

I dashur Hashim,
Pasi lufta në shtetin tonë krijoi edhe gjykime duke dënuar ushtarë komandantë të UÇK-së nga më të ndryshmet, kine për faje individuale dhe reagimet ishin individuale e rajonale dhe ne duke e ruajtur miqësinë me aleatët. Ato gjykime dëmtuan rëndë imazhin tonë. Ata na dënonin pa e kuptuar peshën e gjakut të historisë. Por, ne si popull kemi kaluar një luftë të tmerrshme me dhunë, me kërcënime, me vrasje, me masakra e me djegie të kufomave dhe bartje, deportim të kufomave nga Kosova në Serbi, me kamionë frigoriferë për t'i zhdukur Serbia gjurmët e krimet. Po, as sot, nuk i kem as eshtrat e familjarëve tanë, ku të vëmë lule e të dimë që kanë

një varr, ndërsa disa policë e ushtarë serbë që luftuan në Kosovë, kokat e ushtarëve dhe viktimitave shqiptare i kanë zier, i kanë ngrënë mishin dhe kafkat i kanë bërë llambadarë, sot i kanë nëpër dhomat e tyre si suvenire e trofe. Këto as në kohën e inkuizicionit nuk janë bërë, çka ka bërë Serbia ndaj shqiptarëve për njëqind vjet. Të gjitha këto i arsyeton vetëm çlirimi i Kosovës nga Serbia, i arsyeton liria jonë, si komb e si shtet. Shpallja e pavarësisë më 2008 është e arritur shekullore e brezave e gjakut të derdhur për liri, miku im, shoku im, bashkëluftëtari im, i nderuari president Hashim. Krijimi i gjykatave pas luftës është gjë e arsyetuar në çdo vend ku ka pasur luftë. Po trajtimi duhet të ishte i barabartë pa dallime etnie, sociale e racore a gjuhe. Po krijimi i Gjykatës Speciale pas gjithë këtyre ishte absurd, por pasi aleatët tanë kërkuan ta bëjmë dhe ne e bëmë në mbështetje ndërkombëtare dhe ne e bëmë duke u bazuar në idealin tonë të pastër dhe luftën tonë të drejtë. Duke harruar se drejtësia është alternativë në politikë, rrethanë politike dhe politikë për ta arritur qëllimin. Gjykata Speciale ishte e padrejtë dhe tashmë duhet të përballemi me këto padrejtësi. Ju ishit ndikues në themelimin e saj, i dashur Hashim por, ju sot, jeni edhe sfidues i saj, në këtë gjykatë. Sot aty je si president i vendit tim, i një vendi, i një populli që nga lashtësia jeton në këto troje, nga etruskët, pellazgët, ilirët, arbërorët, albanët dhe shqiptarët. Aty je, sot, që ta mbrosh luftën tonë të shenjtë për liri, të drejtën tonë si komb për pavarësi, ta mbrosh Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e drejtë të saj çlirimtare.

Në historinë tonë për herë të parë del para një gjykatë ndërkombëtare një president. Del para gjykatës një ushtar që ka luftuar për liri, të një populli të vuajtur e të shtypur padrejtësisht, për shekuj e për një shekull duke përjetuar të gjitha fyerjet e poshtërimet, vrasjet e dhunimet, torturat e deportimet, djegiet e shkatërrimet. Pavarësisht prej gabimeve, ti je sot, aty Presidenti im, që mbron popullin tim, mbron kombin tim, mbron idealin e lirisë, mbron luftën tonë të drejtë e të shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbron të kaluarën dhe të ardhmen tonë si komb shqiptar e si shtet. Unë besoj në luftën tonë të drejtë. Unë besoj dhe tek aleatët tanë. Në luftën e përbashkët për liri. Ne si popull asnjëherë në histori nuk kemi bërë krime ndaj askujt. Ne si popull asnjëherë nuk iu kemi frikësuar drejtësisë. Iu kemi frikësuar padrejtësisë që u bë ndaj nesh përherë në histori. Përballja me drejtësinë, ka sfida shoku im president, dhe këtë do ta tejkalojë, ashtu siç na njohu Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, të drejtën tonë për pavarësi, dhe kjo Gjykatë Speciale në Hagë do ta njohë të drejtën tonë, luftën tonë të Ushtrisë Çlirimtare për liri e çlirim nga Serbia. Nuk ka gjykatë që do të mund ta gjykojë luftën tonë për liri, nuk ka demokraci perëndimore në botë që do ta gjykojë lirinë tonë, përveç armiqve tanë. Unë besoj se do t'ia dalësh, zoti president! Bashkëluftëtari im, Hashim. Mirë se vjen fitimtar!

(Autori është ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipëri)

Telekomi kërkon ndihmën e qeverisë dhe të prokurorisë në rastin me 'Z-Mobile'

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 KORRIK - Me një vendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 06.07.2020 u refuzua prapësimi i debitorit Telekomi i Kosovës dhe u kalua në fuqi te përmbaruesi privat urdhri përmbarimor për shumën e obligimit financiar prej rreth 24.6 milionë euro ndaj 'Dardafon.net' ('Z-Mobile'). "Me këtë vendim të procedurës së përshtetshme përmbarimore, të papeshuar dhe vlerësuar sa duhet, Telekomi i Kosovës po kërcënohet me falimentim. Edhe pse ekzistojnë mundësi ankimi në Gjykatën e Apelit, e njëjta nuk e prolongon medoemos ekzekutimin e urdhrit përmbarimor. Kompania 'Dardafon.net' u themelua në nëntor 2008 dhe vetëm dy muaj më pas, më 16 janar 2009, nënshkruan me Telekomin e Kosovës (atëherë PTK-ja) marrëveshjen e mbështetjes së operatorit të rrjetit mobil virtual. 'Z-Mobile' duke shfrytëzuar ndër vite rrjetin e PTK-së, duke marrë favore në ndarjen e të hyrave në raportin 73% : 27%, duke shitur produktet e Telekomit të Kosovës nën çmim, ka konkurruar në mënyrë jo të rregullt jo vetëm PTK-në, por edhe operatorët e tjerë. Qoftë për shkak të kushteve të pafavorshme në kontratë, qoftë për shkak të kamatave enorme, borxheve të fryra e të paqena, të krijuara përmes një procesi krejtësisht të dyshimtë e të mjegullt, të cilin duhet hetuar me kujdes, Telekomi i Kosovës u soll në një situatë kur një kompani virtuale e cila operoi me paratë e Telekomit të Kosovës tani po pretendon ta falimentojë atë. Nga raportet e hartuara të ekspertëve të brendshëm të kompanisë si dhe të atyre të

jashtëm është bërë vlerësimi që humbjet reale të Telekomit të Kosovës, nga kjo kontratë dalin të jenë qindra milionëshe", është thënë në komunikatën e Telekomit.

Më tej në këtë komunikatë theksohet se pasojat e këtij përmbarimi të përshtetshme, përveçse do të jenë të karakterit social dhe ekonomik, do të jenë edhe të karakterit politik, nacional dhe legal, pasi që e gjithë kjo rrezikon të shpërthejë si afëra më e madhe korruptive në gjithë historinë e Republikës së Kosovës. "Tashmë pengimi i 'gëlltitjes' së Telekomit të Kosovës varet nga ndërhyrja e shtetit për të ndaluar anuluar përmbylljen e suksesshme të këtij procesi të dyshuar publikisht si korruptiv. Ky proces kishte filluar dhe ishte realizuar me vullnetin e individëve influencues politikë dhe të bordeve politike të PTK/Telekomit të Kosovës që synonin zhvlerësimin e Telekomit të Kosovës dhe shitjen e tij me çdo kusht, apo përfitim nëpërmjet aksioneve të korporatës. E vetmja forcë e cila ende mund dhe duhet të merret me ruajtjen e Telekomit të Kosovës si aset nacional ka mbetur Qeveria e vendit, e cila e ka për obligim ligjor e kushtetues që ta kontestojë gjithë procesin e grabitjes së Telekomit të Kosovës dhe si përfundim të anulojë atë, duke ia kthyer publikut atë që i takon. Rrjedhimisht fati i kompanisë dikur më të suksesshme në vend e në rajon, e cila aksionarit i dha dividendë qindra milionëshe, tani është në dorën e Prokurorisë së shtetit dhe të Qeverisë së Kosovës", theksohet në komunikatën e Telekomit të Kosovës.

Telekomi i Kosovës ka ftuar Prokurorinë e Shtetit t'i



ndërmarrë hapat dhe veprimet emergjente për ta ndaluar procesin e shkatërrimit të qëllimshëm të këtij aseti nacional, që prek edhe në themelet e sigurisë së vendit. "Vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve për institucionet e shtetit dhe publikun, zinxhiri funksional ekonomik në relacion me bizneset kontraktuese dhe siguria e mirëqenies së punëtorëve është obligim kushtetues dhe duhet të mbrohet nga drejtësia e shtetit e jo të cenohet dhe lihet në mëshirën e oligarkëve", thuhet në këtë komunikatë, duke theksuar më tej se disa kallëzime penale të cilat Telekomi i Kosovës i ka iniciuar në prokurori, indikojnë prova të mjaftueshme se kontrata e vitit

2009 (dhe veprimet para nënshkrimit të saj) me 'Dardafon.net' përmbajnë elemente të veprës penale, të cilat duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare. "Ekzekutimi i këtij përmbarimi duhet të prolongohet derisa të përfundojnë të gjitha proceset legale të iniciuara nga Telekomi i Kosovës e që ndërliiden me raportin komercial të TK me 'Dardafon.net'. Korporata është duke e rishqyrtuar mundësinë e ligjshmërisë së vendimeve duke e ngritur në vëmendje të prokurorit çështjen në fjalë. Telekomi i Kosovës ka kapacitete njerëzore, profesionale dhe ka vullnet të fuqishëm për t'i shërbyer konsumatorët e vet dhe për të krijuar sërish dividendë të fuqishme për aksionarin. Edhe

sot, përkundrajt të gjitha destruksioneve në drejtim të saj, mbetet ofruesi më i besueshëm dhe më i preferuar i qytetarëve të Republikës së Kosovës, prandaj meriton të mbrohet, të konsolidohet dhe të fuqizohet", thuhet në këtë komunikatë. Më tej thuhet se "drejtuesit dhe punonjësit e Telekomit të Kosovës, edhe më tutje mbesin në besim se Qeveria e Republikës së Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe institucionet e tjera shtetërore nuk do të lejojnë që të ndodhë falimentimi i kësaj kompanie. Bëjmë thirrje publike që në procesin e konsolidimit dhe ristrukturimit ta kemi mbështetjen e plotë dhe ndihmën e pakursyer të aksionarit dhe institucioneve relevante të shtetit".

Tahiri: Do ta ulim barrën administrative për ta rritur punësimin dhe investimet

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Tahiri, ka biseduar të martën me drejtorin e Zyrës së GIZ-it në Kosovë, David Oberhuber, shefen e Zyrës për Bashkëpunim për Zhvillim nga Ambasada Gjermane, Anja Becky dhe udhëheqësin e ekipit të projektit të Qeverisjes Financiare, Kadri Sternberg. Në këtë rast, ku është biseduar për Programin për Zvogëlimin e Barrës Administrative dhe legjislacionet e tjera të cilat Qeveria po i përkrah me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e një kornize adekuate të politikave, bashkëbiseduesit u



pajtuar që të bëhet ulja e barrës administrative, e cila do të ndikojë në rritje ekonomike dhe do të krijojë mundësi për rritjen

e investimeve. Zëvendëskryeministri Tahiri vuri theksin se barrierat administrative janë si zinxhirë

që e mbajnë ekonominë tonë poshtë. "Ne duhet t'u japim bizneseve tona shanse të rriten në mënyrë që të investojnë dhe të punësojnë sa më shumë njerëz. Kësisoj ulja e barrës administrative me 30 për qind do të na japë rritje ekonomike midis 1.6 për qind dhe 3.6 për qind të PBB-së", ka thënë zëvendëskryeministri Tahiri. Po ashtu, zëvendëskryeministri Tahiri ka pohuar se ne duhen thyer zinxhirët, në mënyrë që ta zhbllokojmë këtë rritje, duke eliminuar të gjitha procedurat e panevojshme, thjeshtuar ato që i duhen shoqërisë sonë dhe investuar në shërbime digjitale.

Në këtë frymë, siç ka thënë ai, politika për zvogëlimin e barrës administrative do të bëhet pjesë e pandashme e vendimmarrjes së qeverisë. Në frymën e bashkëpunimit dhe partneritetit strategjik, u pajtuan t'i përqendrojnë përpjekjet në Ligjin për Qeverinë, Ligjin për Pagat dhe planifikimin e politikave qendrore dhe lokale. Zëvendëskryeministri Tahiri ka falënderuar Zyrën e GIZ-it në Kosovë dhe Ambasadën Gjermane për përkrahjen dhe udhëzimet e tyre të vazhdueshme për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe proceset e reformës në Kosovë.

Komuna e Skenderajt dhe 'Help Kosovo' përkrahin 22 biznese të vogla

SKENDERAJ, 14 KORRIK (ER) - Njëzetë e dy (22) qytetarë të Komunës së Skenderajt kanë nënshkruar kontratat e tyre me Komunën e Skenderajt dhe organizatën "Help Kosovo", për përfitimin e granteve në vlerë deri 2 000 euro për secilin përfitues. Organizata "Help Kosovo", përfituesve do t'ua mbulojë shpenzimet për sigurimin e mjeteve që atyre u nevojiten për t'i realizuar idetë e tyre biznesore apo për të zgjeruar biznesin e tyre. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, duke falënderuar organizatën "Help Kosovo" për bashkëpunimin dhe përkrahjen e dhënë qytetarëve të Skenderajt, i uroj përfituesit e

granteve duke shpresuar bizneset e tyre të kenë rritje dhe kështu të punojnë edhe të rinj të tjerë. "Urime të gjithë përfituesve! Shpresoj që herën tjetër të takohemi te bizneset e juaja, duke i parë ato se sa shumë janë zgjeruar, kanë ecur përpara si rezultat i këtyre garantëve dhe përkushtimit tuaj", ka thënë Jashari.

Ndërsa drejtoresha e kësaj organizate, Shqipe Breznica, ka shprehur mirënjohje ndaj kryetarit Jashari dhe Drejtoreshës së Zhvillimit Ekonomik, Sanije Hoxha, për bashkëpunimin e dhënë gjatë kësaj periudhe. "Urime të gjithë juve që keni fituar, ne si qëllim kemi krijimin e vendeve të reja



të punës, në mënyrë që kështu ta mbajmë stabilitetin socioekonomik të vendit. Dua ta falënderoj shumë kryetarin sepse pa kryetarin dhe drejtore-

shën Sanije Hoxha ky projekt nuk do të ishte realizuar", ka thënë Breznica. Edhe fituesit e këtij projekti kanë shprehur entuziazëm për

realizimin e ideve të tyre të biznesit, me ç'rast kanë shprehur falënderime ndaj kryetarit Jashari dhe "Help Kosovo" për mbështetjen e dhënë.

Komuna e Mitrovicës shpërndan rreth 1 000 maska për qytetarët



MITROVICË, 14 KORRIK (ER) - Me iniciativë të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës të martën janë shpërndarë rreth 1 000 maska për qytetarët kalimtarë në sheshet e qytetit të Mitrovicës. Me këtë rast, nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtoreshën për Shëndetësi, Erseka Hasanaj Barani, dhe drejtorët komunalë, Nehat Bahtiri, Tafil Peci, Nazan Kërveshi, Shukri Gashi, Hysni

Ahmeti dhe Hysen Muzliukaj kanë bërë shpërndarjen e maskave dhe disa broshura informative për qytetarët.

Ky aktivitet simbolik kishte për qëllim realizimin e fushatës vetëdijesuese përmes së cilës të arrihet ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të maskave, që konsiderohet një prej masave më mbrojtëse ndaj virusit Covid-19.

Gjatë shpërndarjes së këtyre

maskave, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ka informuar qytetarët për rëndësinë e përdorimit të maskave në këtë kohë pandemie si dhe ka kërkuar që të jenë të kujdesshëm dhe ta mbrojnë shëndetin e tyre, pasi që në këtë mënyrë ruajnë familjen dhe shoqërinë. Ndërsa qytetarët e mirëpritën dhe u shprehën të kënaqur me iniciativën e marrë nga kjo drejtori, me shpresën që këto aktivitete të jenë më të shpeshta.

Haziri: Përpos ruajtjes së shëndetit publik, sfidë ka qenë edhe ruajtja e shëndetit të ekonomisë

GJILAN, 14 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në takim publik me qytetarët të organizuar përmes platformës online, e cila është mundësuar nga DEMOS, ka folur për sukseset, sfidat e problemet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Haziri ka thënë se këtë gjashtëmujor e karakterizon përballja me pandeminë Covid-19, duke thënë se, përpos ruajtjes së shëndetit publik, sfidë ka qenë edhe ruajtja e shëndetit të ekonomisë. "Faleminderit DEMOS-it për mbështetjen dhe organizimin e takimit publik përmes platformës online në kushte pandemie. Gjashtëmujori

i parë i vitit 2020 karakterizohet me pandeminë Covid-19. Vitin e kemi filluar me Flakën e Janarit që sivjet i është kushtuar Abdullah Tahirit dhe në shkurt kemi punuar në plane për përgatitjet organizative në përputhje me buxhetin, objektivat dhe synimet, duke organizuar të gjithë sektorët, e duke ndërtuar ambicie për një vit dinamik dhe buxhetor, i cili pritej të jetë në interes të zhvillimit projekteve zhvillimore të Gjilanit", ka thënë Haziri gjatë adresimit para qytetarëve.

Kreu i Komunës së Gjilanit ka thënë se më 22 shkurt kanë filluar masat anti Covid, sipas reko-



mandimeve të IKShP-së. "Më 13 mars e kam nxjerrë vendimin mbi themelimin e Komitetit kundër Covid dhe Qendrës Operative Emergjente, të cilët

punojnë çdo ditë për t'i trajtuar rastet dhe kërkesat e qytetarëve", ka thënë Haziri, duke shtuar se mbi 5 000 familje u kanë asistuar me pako ushqimore dhe

higjienike. Ai ka pohuar se Komuna e Gjilanit është në përfundim të vlerësimit të dëmeve në ekonomi e bujqësi dhe shumë shpejt do të dilet me qëndrim zyrtar.

Sa iu përket investimeve publike, Haziri ka thënë se këto po bëhen mbi parimin e barazisë qytet-fshat. Pavarësisht prej vështirësive që ka sjellë pandemia, kryetari Haziri ka thënë se arsimi është dikasteri që shumë suksesshëm e ka përballuar, duke u bërë komuna e parë që e fillon aplikimin e mësimit nga distanca, derisa bujqësia ka thënë se e ka ruajtur kalendarin e subvencionit të fermerëve.

Fshati Muçiverc së shpejti bëhet me rrjet të mbeturinave

KAMENICË, 14 KORRIK (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht udhëheqësi i sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, Hysen Jerliu, së bashku me menaxheren e njësisë së "Ecohigjienës", Shejnazë

Masurica, kanë mbajtur një takim me përfaqësuesit e fshatit Muçiverc për të diskutuar në lidhje me shtrirjen e rrjetit për mbeturina në këtë fshat.

Gjatë shtrirjes së rrjetit të mbeturinave do të dhurohen edhe

kontejnerë familjarë 120 litra. Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se shtrirjen e rrjetit për mbeturina janë duke e vazhduar edhe në fshatin Muçiverc. "Shtrimin e rrjetit për menaxhim të mbeturinave

po e vazhdojmë edhe në Muçiverc. Për banorët e këtij fshati që nuk kanë pasur kontejnerë familjarë, tani po ua dhurojmë ato falas me kapacitet prej 120l sosh. Hysen Jerliu nga drejtoria për Shërbime Publike ka takuar



përfaqësuesit e këtij fshati bashkë me 'Ecohigjienën', ku edhe u janë sqaruar të gjitha procedurat", ka thënë Kastrati.

NË EVROPË NUK DUHET FOLUR MË PËR SHQIPTARËT ME GJUHËN E SERBISË (7)



Shkruan: Kudusi LAMA

Evropa mori mbi vete barrën që të përfaqësohet me një raport politik për shqiptarët, si raport i Dick Martyt. Ky është një tregues i qartë se atje po vazhdon akoma të flitet për shqiptarët me gjuhën e Serbisë. Kjo nuk është e moralshme, por ja që është e vërtetë.

Ne jemi mësuar të na trajtojnë keq, ndaj nuk na bën shumë përshtypje. Ashtu sikurse jemi mësuar gjithnjë të kemi disa prej tanëve që ua krehin bishtin atyre që na shajnë e akuzojnë. Por na vjen keq, sepse deri sot Evropa nuk ka parë asnjë të keqe prej shqiptarëve, ndaj edhe duket befusuese kjo gjuhë e helmët që vjen prej Evrope, me synime si këto ku kemi arritur.

Në jetën kombëtare shqiptare kemi një veprimtari miqësore me Evropën dhe me gjithë shtetet e saj e kombet të marra veç e veç. Konflikti ynë qëndron vetëm me ata që na kanë përvetësuar e tjetërsuar trojet tona, të cilat nuk mund dhe nuk do të mund kurrë të pranojmë të na mbeten të kolonizuara. Në gjithë historinë tonë, u kemi bërë mjaft nder të gjitha vendeve evropiane. Ashtu sikurse edhe nuk kemi pasur mundësi e fuqi t'u bëjmë nder, por me garanci asnjë të keqe nuk u kemi bërë.

Prandaj edhe ndiejmë dhembje kur shikojmë e dëgjojmë të instalohet gjuha e Serbisë në gojën e institucioneve të Evropës. Jemi mësuar me shumë raporte që na kanë persekutuar në emër të Evropës. Por të bëhet një raport kundër shqiptarëve të cilët ishin bashkëluftëtarë të Evropës kundër krimit. Ose më saktë të bëhet një akuzë kaq e rëndë ndaj atyre që vetë Evropa zgjodhi të bëhet bashkëluftëtare e tyre në luftën kundër të keqes, krimit dhe mesjetarizmit. Kjo duke e pa arsyetuar. E pikërisht kjo Evropë, tani na del se paska njohur një ushtri kriminale që drejtohej nga disa kriminelë e kanibalë, që paskan punuar për të grabitur organet jetësore të serbëve, se nuk paskan pasur ndonjë synim tjetër në luftën e tyre. Pra, kjo Evropë që e ndërroi shtratin njëherë në vitin 1999 dhe u bë pjesë e vendosjes së drejtësisë për shqiptarët, tani po kupton se nuk paska vepruar mirë. Evropa po kthehet kështu në shtratin e vjetër të saj, atë të përbuzjes dhe denigrimit të shqiptarëve, shtrat i njohur ky për në dhe për të. Por që na vjen keq, vetëm pse akoma kjo

Evropë ka shumë dëshirë të na sakrifikojë për interesat e Serbisë? A nuk është kënaqur akoma? Deri kur do të vazhdojë kështu?

Dick Marty, diplomati zviceran i njohur si politikani kundër pavarësisë për Kosovën, merr edhe një herë penën të shkruajë çfarë i thonë për shqiptarët, duke u munduar t'i paraqesë ata si të keqen më të madhe të Evropës. Unë jam i sigurt se ai e di mirë atë thënien serbe "shqiptar i mirë është vetëm shqiptari i vdekur", sepse pikërisht këtë thotë edhe vetë vetëm se në një formë më të sofistikuar.

Janë raporte të tilla, të cilët mundësojnë që edhe shkrimtarë të njohur e me reputacion si Roberto Saviano, autori i librit "Kamorra", në një bisedë në televizionin "Topcenell", me gazetaren Rudina Xhunga, në emisionin "Shqip", diku në pranverë të vitit 2011, u dëgjua të thotë se "edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës që ju e respektoni, nuk është gjë tjetër veçse një organizatë mafioze". Të kesh fuqi të thuash fjalën dhe të flasësh kështu pa përgjegjësi për t'i fyer të tjerët, nuk më duket gjë e mirë. Deklarime të tilla nuk duhet të zënë vend në agjendën e njerëzve të cilët e kanë për detyrë të jenë të drejtë në marrëdhënie me botën.

Por ja që është e çuditshme se gjithkush që intervistohet në Shqipëri dhe për shqiptarët bën si ekspert i kriminalitetit. E jo gjithkush është ekspert, këtë duhet ta kemi të qartë. Mos t'i marrim shumë seriozisht ato që thonë e deklarojnë të tillë "ekspertë", të paktën ne për veten dhe njerëzit tanë, pasi do të ndihemi në pozitë të keqe, duke menduar vetëm keq për veten tonë. Realisht duhet të bëjmë që të tilla deklarata të vlerësohen me sy kritik. Të mos merren thjesht si të vërteta vetëm pse i kanë thënë të huajt sepse, siç duket, edhe ata e kanë kuptuar se ne jemi shumë të ndikueshëm nga opinionet dhe i lëshojnë të papjekura fare kur është puna për shqiptarët.

Kërkoj mirëkuptimin e lexuesit, pasi unë nuk synoj të arsyetoj se gjithçka që bëjmë ne është e kulluar. Por këto opinione dhe deklarata, që i bëjnë të huajt, qofshin individë apo organe politike, po shfrytëzohen shumë në të ashtuquajturën politikë të brendshme, që po i prishin shumë punë zhvillimit të vendit. Mezi pritet të bëhet një deklaratë qoftë edhe gjysmake nga një i huaj, që të hidhen në sulm politikanët e vendit kundër të "akuzuarit", siç konsiderohet ai që akuzohet nga një i huaj se, ndoshta, nuk i kanë mbajtur pallton apo çantën. Unë i mirëkuptoj ata që punojnë dhe investojnë për karrige pushteti,

ata le të shfrytëzohen deklarata të tilla e të tjera më të rënda kur gjejnë terren. Ama, kur është në fjalë morali kombëtar dhe vlera historike kombëtare, mendoj se duhet t'i vëmë gishtin kokës e frerin gjuhës dhe t'i tregojmë vendin gjithkujt që na hedhë gurë mbi ta.

Institucionet e Evropës, duke marrë përgjegjësi të bëjnë deklarata si ajo që miratoi Këshilli i Evropës mbështetur në raportin e Dick Martyt, merr përgjegjësi t'i përbaltë vlerat kombëtare shqiptare, të cilat ne i kemi të shenjta. Kjo përbaltje, askujt nuk i ka bërë nder vetëm Serbisë e pse jo edhe Greqisë (por që nuk është me interes të merrem tani me të, pasi ndoshta në të ardhmen duhet të them shumë gjëra edhe për të). Pse pra duhet të vazhdojmë të



dëgjojmë këtë melodi evropiane kundër shqiptarëve e pro serbe? A nuk është bindur Evropa se me shpifje e veprime kundër shqiptarëve nuk e ndihmon dot Serbinë? Unë mund të them se me Serbinë jemi mësuar. Atë dimë mirë si ta luftojmë dhe do ta luftojmë deri kur të mësojmë të rrijë si e barabartë në mes të të barabartëve. Po Evropa pse? Kaq shumë kënaqet ajo nëse ne lëmë të na shkelin e skllavërojnë serbët? Çudi.

Kur është deklaruar raporti i Dick Martyt, duke shfletuar literaturë për ta vlerësuar gjendjen, kam veçuar një qëndrim, në të cilin thuhet: "Nuk ka qenë habi që dokumente, projekte dhe pamflete antishqiptare kanë bërë qarqet politike e akademike në Beograd që në shekullin e nëntëmbëdhjetë (Naçertania e Garaçaninit) ato të fillimshkullit njëzet (Andriq), të gjysmës së dytë të shekullit njëzetë (memorandumi i ASHA-së të Serbisë dhe Francuska 7 e Beogradit) sepse vinin nga një shtet që kishte spastruar territoret etnike shqiptare, kishte pushtuar gjysmën e territoreve shqiptare dhe në fund u përpoq ta bënte edhe pastrimin etnik të Kosovës në vitet 1998-1999.

Sot ende nuk janë shëruar plagët nga krimet serbe në Kosovë, ku

vendi ynë u ballafaqua me politikën dhe strategjinë e tokës së djegur, të spastrimit etnik, të vrasjes, masakrimit dhe dëbimit të mbi një milion banorëve nga tokat e tyre. Ende nuk janë gjetur gjurmët e të zhdukurve dhe shumë të vrarëve nga makineria paramilitare, ushtarake dhe policore serbe, ende nuk ka kërkimfalje për krimet serbe në Kosovë, kur del një senator zviceran dhe përpiket ta kthejë me kokë së prapthi historinë, duke e njoollur luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të kreut të saj drejtues.

Në raportin e tij prej 40 faqesh Dick Marty përpiket ta nxijë dhe ta vrasë politikisht kapitullin më të ndritur të historisë së re të Kosovës, luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përpiket që t'i denigrojnë

moralisht dhe politikisht drejtuesit e UÇK-së. Jo z. Marty, nuk njoollen me shpifjet tuaja rrëqethëse ata që vetëm në saje të drejtësisë, korrektësisë dhe sprovave të vazhdueshme arritën që të gjejnë përkrahje në qarqet më të larta të diplomacisë amerikane dhe asaj evropiane, duke e ngritur në pikën më të lartë çështjen e Kosovës".

Nuk arrij të kuptoj, a kanë institucionet evropiane një masë matëse të njëlojtë për të gjithë dhe të përhershme, apo e ka një masë sipas opinionit që ka apo që krijon për njërin e për tjetrin? Apo e ka një masë sot me një përmasë e nesër me një përmasë tjetër. Mendoj se ka ardhur koha të kemi edhe në autoritetin tonë, pavarësisht nëse blejnë serbët edhe diplomatë politikanë evropianë me para për të folur e vepruar kundër shqiptarëve. Ne kemi aq fuqi intelektuale dhe politike sa të arsyetojmë gjithçka dhe të japim prova të normalitetit të jetës e të historisë tonë.

Dje UÇK-ja ishte bashkëluftëtare e NATO-s, bashkëluftëtare e Evropës, bashkëluftëtare e të gjitha forcave përparimtare e moderne të kohës. Si nuk bëhet një analizë, por shpifet pa asnjë lloje kriteri, veçse kështu kanë dëshirë serbët? Realisht Evropa duhet t'u thotë mjaft serbëve e Serbisë. Mjaft u ka shkuar sipas

avazit. Më duket se ka ardhur koha që Evropa ta mbrojë veten nga tendencat e sllavizimit. Ne shqiptarët e kemi mbrojtur veten kur kemi qenë një popull i vogël e i papërfillur. Jo më sot që jemi 10 milionë shqiptarë vetëm në Ballkan e që do të jemi edhe 100 % të çliruar shumë shpejt. Prandaj është mirë që Evropa të mos mendojë më se ne jemi një komb i vogël i Evropës. Sepse jemi më i madh edhe se serbët edhe se grekët. Por në radhë të parë ne duhet të kuptojmë vetë se jemi një komb i madh dhe të qëndrojmë e të sillemi si i tillë.

Edhe për sa kohë Evropa do të flasë për shqiptarët me gjuhën e Serbisë? Deri kur Evropa do ta përkëdhelë Serbinë në kurriz të shqiptarëve? A nuk ka ardhur koha të shikohen serbët si një popull që duhet të mos ndërtojë më interesat e tyre mbi interesat e të tjerëve dhe në dëm të tyre? Ne jemi evropianë, si të gjithë evropianët e tjerë. Askush nuk ka të drejtë të drejtojë gishtin më mbi shqiptarët e trojet e tyre. Askush nuk duhet lejuar më që të na konsiderojë një mjet për përmbushje të interesave të dikujt. Ne jemi ata që duhet të tregojmë me vepra, se vlejme të mos na vënë kurrë në balancën e tregut evropian. Ishte një herë ajo kohë. Evropa duhet të ndryshojë sjellje ndaj shqiptarëve.

Nëse bëmë luftë kundër Serbisë nuk ishim ne fajtorët. Ne ishim të pushtuar e duhej të çliroheshim. Ne ishim të kolonizuar e duhet ta kishim lirinë tonë. Pse doli se paska qenë një faj kjo luftë? Si ka mundësi Evropa të harrojë se ç'hoqëm ne shqiptarët nga pushtimi serb e jugosllav? A ka logjikë të qëndrojmë mendimi se shqiptarët qenkan ngritur në luftë, se paskan dashtë të grabisin disa organe jetike të njerëzve të Serbisë? Serbia me mbi 60 mijë ushtarë e 12 mijë policë në Kosovë, Serbia me 63 mijë civilë të armatosur në Kosovë, Serbia me mbi 8 mijë paramilitarë, mbi 5 mijë kriminelë e disa qindra agjentë të UDB-së në Kosovë, Serbia me një administratë të armatosur e të pamëshirshme në Kosovë, shqiptarët të vrarë, të masakruar, të zhdukur, të shpërngulur, të burgosur, të përdhunuar, të paushqyer, të papunë, të grabitur, të helmuar, njëkohësisht shqiptarët fajtorë për të gjitha këto. Kjo Evropë më duket se nuk është normale.

Thuhet se Evropa i do lirinë dhe demokracinë, thuhet se Evropa i do zhvillimin dhe unitetin, thuhet se Evropa i do përparimin dhe paqen, thuhet se Evropa ka ideale për të ardhmen. Po pse nuk i ka këto edhe për shqiptarët e trojet e tyre po i trajton si kanë dëshirë serbët dhe sllavët në përgjithësi?

(Vijon)

Bosnje dhe Hercegovina hap kufijtë për vendet e BE-së

SARAJEVË, 14 KORRIK - Bosnje dhe Hercegovina do t'i hapë kufijtë e saj për qytetarët e Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen. Gjatë hyrjes në territorin e Bosnjës, udhëtarët nga këto vende duhet të kenë një test negativ për koronavirus, ka bërë me dije kryetari i Këshillit të

Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Zoran Tegeltija. "Testi nuk duhet të jetë më i vjetër se 48 orë", ka thënë Tegeltija.

Bosnja i ka mbyllur kufijtë për qytetarët e BE-së para katër muajsh. Që nga 1 qershori, Bosnja ka hapur kufijtë e saj për qytetarët e Serbisë, Malit të Zi

dhe Kroacisë, pa kufizime shtesë, dhe në përputhje me masat epidemiologjike të nxjerra nga institutet epidemiologjike.

Të martën në Bosnjë dhe Hercegovinë janë konfirmuar 189 raste të reja me koronavirusin e ri, që e shkakton sëmundjen Covid-19.



Britania e Madhe e përjashton Huaweiin nga rrjeti 5G

LONDËR, 14 KORRIK - Kryeministri britanik Boris Johnson ka urdhëruar që pajisjet e kompanisë kineze Huawei të hiqen plotësisht nga rrjeti 5G i Britanisë së Madhe deri në vitin 2027.

Vendimi është një sinjal se prodhuesi më i madh i pajisjeve të telekomit në botë nuk është i mirëpritur në

Perëndim dhe pritet ta nxisë zemërimin e Kinës. "5G do të ketë rol transformues për vendin tonë, por vetëm nëse kemi besim në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës mbi të cilën është ndërtuar. Pas sanksioneve amerikane kundër Huaweiit dhe këshillave teknike nga

ekspertët tanë, qeveria ka vendosur se është e nevojshme të ndalohet Huawei nga rrjetet tona 5G", ka pohuar sekretari britanik për digjitalizim, Oliver Dowden.

Një zëdhënës i Huaweiit ka njoftuar se ky është një lajm zhgënjës për këdo që mban një telefon celular në Mbretërinë e Bashkuar.



Trumpi uron presidentin polak për rizgjedhje

WASHINGTON, 14 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka uruar homologun e Polonisë, Andrzej Duda, për sigurimin e mandatit të dytë presidencial në balotazhin e 12 korrikut. "Përgëzime mikut tim, presidentit të Polonisë, Andrzej Duda, për rizgjedhjen e tij historike. Pres ta vazhdojmë punën tonë të rëndësishme në shumë çështje, përfshirë

mbrojtjen, tregtinë, energjinë dhe sigurinë e telekomunikimeve", ka shkruar Trump në llogarinë e vet në "Twitter". Komisioni Kombëtar Zgjedhor i Polonisë ka njoftuar të hënën se Duda i ka fituar zgjedhjet e së dielës me 51.03 për qind të votave. Rivali i tij, kryetari i Varshavës, Rafal Trzaskowski, ka marrë 48.97 për qind të votave. Duda është mbështetur nga Partia në

pushtet për Ligj dhe Drejtësi. Rezultati do të thotë se kjo parti dhe udhëheqësi i saj, Jaroslaw Kaczynski, do ta konsolidojnë tutje pushtetin dhe do t'i shmangin skenarët ku një president i opozitës do ta kishte mundësinë e vetos në legjislacion. Rezultati i zgjedhjeve do ta formësojë politikën e Polonisë së paku deri në vitin 2023, kur janë planifikuar zgjedhjet parlamentare.



Franca ua rrit pagat punëtorëve shëndetësorë

PARIS, 14 KORRIK - Franca ka miratuar rritje të pagave në vlerë prej 8 miliardë eurosh për punëtorët shëndetësorë, të cilët janë lavdëruar për rolin e tyre në luftimin e koronavirusit. Marrëveshja u nënshkrua të hënën vonë midis qeverisë dhe sindikatave të punëtorëve, pas disa javësh negociatave. Në bazë të saj, paga do të rritet

për 183 euro në muaj. Punëtorët shëndetësorë në Francë janë lavdëruar gjatë gjithë kohës së pandemisë së koronavirusit, me shfaqje të rregullta të vlerësimit të publikut. Megjithatë, ata kanë zhvilluar protesta për të kërkuar rritje të pagave dhe fonde më të mira për spitalet. "Ky është një moment historik për sistemin tonë

shëndetësor", tha kryeministri i Francës, Jean Castex, pas nënshkrimit të marrëveshjes për rritje pagash. "Kjo është, para së gjithash, mirënjohje për ata që kanë qenë në vijën e parë të frontit kundër pandemisë", ka shtuar ai. Franca ka regjistruar mbi 200 000 raste me koronavirus. Prej tyre, mbi 30 000 kanë humbur jetën.



'Google' do të investojë 10 miliardë dollarë në Indi

NJU-JORK, 14 KORRIK - Kompania e kërkimeve në internet 'Google' do të investojë 10 miliardë dollarë në Indi, gjatë 5-7 vjetëve të ardhshëm, ka bërë me dije shefi ekzekutiv i kompanisë simotër, Alphabet Inc. Sundar Pichai foli në një ngjarje vjetore të 'Google' për Indinë, të mbajtur online. Investimet u tha se do të përdoren për të ndërtuar

produkte dhe shërbime për Indinë dhe për ta ndihmuar digjitalizimin e bizneseve. "Ky është reflektim i besimit tonë në të ardhmen e Indisë dhe në ekonominë e saj digjitale", ka thënë Pichai.

Me më shumë se 500 milionë përdorues aktivë të internetit, India është mbase tregu më i madh në rritje për 'Google'.

Pichai, gjithashtu, shprehu mbështetje për projektin e

kryeministrit të Indisë, Narendra Modi, për digjitalizimin e Indisë. Ky projekt synon ta rregullojë infrastrukturën digjitale të këtij vendi.

Modi shkroi në "Twitter" se ai dhe Pichai kanë diskutuar për "përdorimin e fuqisë së teknologjisë në transformimin e jetës së fermerëve, të rinjve dhe sipërmarrësve të Indisë".





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

Rrugët "pushtohen" nga gjarpërinjtë

Një udhëtim drejt Indisë gjatë kësaj periudhe mund të mos jetë një ide fort e mirë, sidomos për ata që kanë frikë nga gjarpërinjtë. Me qindra zvarranikë nxirren në paradë nga banorët e thujse çdo qyteze, pasi besimtarët Hindu bëhen bashkë për të festuar Nag Panchami, Festivalin e Gjarpërinjve. Kjo festë e lashtë mbahet në korrik ose gusht. Turma të mëdha njerëzish ecin rrugëve të qyteteve indiane duke mbajtur në duar gjarpërinj, ndërsa këndojnë e brohorasin. Parapërgatitjet përfshijnë gjuetinë e gjarpërinjve në ujë



apo në vrimat e tyre dhe më pas mbahen nëpër enë të mbyllura derisa nis festivali. Kur kjo ndodh, zvarranikëve u ofrohen qumësht, ëmbëlsira dhe lule. I gjithë rituali përmbillet në një tempull ku

"trimat" që mbajnë në duar gjarpërinjtë "marrin bekimin" nga zotat gjarpër. Hindutë besojnë se këto rituale i bekojnë ata duke larguar karmën e keqe dhe fatkeqësitë.

FOTO E DITES



Foleja e lejlekut në Lloshkobare të Ferizajt.

BARSOLETA E DITËS



E dashura: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur.
I dashuri: Edhe?
E dashura: Të lutem ma bëj një kompliment.
I dashuri: Zemër, ke shikim shumë të mirë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E jashtëzakonshme

Kërkojnë varrin e Kleopatrës, arkeologët bëjnë zbulimin befasues

Arkeologët janë një hap më pranë zbulimit të varrit të humbur prej kohësh të Kleopatrës, pas një zbulimi "të bujshëm" që kanë bërë në një tempull të lashtë në Egjipt. Dy mumie "të një shkalle të lartë shoqërore" janë gjetur në Taposiris Magna, pranë qytetit të Aleksandrisë, dhe po mendohet se mbretëresha mund të jetë varrosur pikërisht atje pas vetëvrasjes së saj tragjike 2 000 vjet më parë. Kleopatra, mbretëresha e fundit e Egjiptit, është një nga

sundimtarët femra më të famshme të historisë, por vendi ku ajo prehet, është ende një mister i pazgjidhur. Disa ekspertë besojnë se ajo u varros në Aleksandri, atje ku lindi dhe sundoi për pjesën më të madhe të jetës së saj. Të tjerë sugjerojnë që ajo gjendet në zonën antike të Taposiris Magna, një qytet port i famshëm ky në kohën e Kleopatrës. Zbulimi i dy mumieve është përshkruar si "sensacional" sepse tregon rëndësinë e nekropolit, ose "qytetit të të vdekurve" në Taposiris.



DASHI
Dita do të nisë plot diell, do të qëndroni

pranë njerëzve që i doni dhe i vlerësoni shumë. Dhe dita nuk do të ketë fund, do të shkëlqejë shumë e më shumë.



DEMI
Aventurat tuaja të fundit nuk do të jenë siç

ju i kishit menduar, përkundrazi do të jenë më voluminoze seç e kishit imagjinuar.



BINJAKËT
Dëshirat tuaja do të jenë më të mëdha nga

sa mund të arrini. Përpiquni të balancooni se çfarë mund të arrini dhe çfarë jo, më pas veproni plot optimizëm.



GAFORRJA
Jeni me shumë fat që keni në krah një njeri

që ju kupton dhe ju mbështet në gjithçka. Është gjysma juaj, dhe pa hatërbetje është më i mirë se ju.



LUANI
Jeni plot fat në këtë periudhë, çdo projekt

apo plan i juaji do të ecë më së miri. Ju duket sikur keni fituar lotarinë, por shfrytëzoni pasi nuk do të zgjasë për shumë kohë.



VIRGJËRESHA
Nëse jeni në dilemë për diçka, nëse ia vlen

apo jo ta vazhdoni, jeni ju ai që e keni zgjidhjen, mos mendoni se fati i keq po ju ndjek, rritni me këmbë në tokë dhe gjejini zgjidhjen te vetja.



PESHORJA
Keni pranë vetes njerëz që kanë nevojë

për mbështetjen tuaj, por do të kenë pak nevojë për bindjen tuaj. Nuk duhet t'u rri në kohë duke ua bërë me dije që e kanë gabim.



AKREPI
Keni nevojë për më shumë kohë për t'i

rregulluar situatat e komplikuar që ju ka sjellë jeta. Prandaj merrni me qetësi, pa e kthyer kokën mbrapa.



SHIGJETARI
Ndonjëherë përpiquni të jeni më transparente

me të tjerët, mos i bëni të tjerët të duken qesharake. Jepini hapësirë ta tregojnë veten, në atë vend nuk jeni vetëm ju.



BRICJAPI
Merreni çdo gjë me entuziazëm se do t'ia

dilni më së miri. E martë tersi për ju, por kjo nuk do të thotë ta dreqosni në çdo gjë.



UJORI
Shkoni atje ku juve ju pëlqen dhe

argëtoheni, s'keni pse shkoni diku dhe të rri në mërzitur. Jo vetëm që mezi do t'i shtyni orët, por dhe do t'i mërzisni të tjerët rrotull jush.



PESHQIT
Do të lëndoheni pak, por do të jetë një

mësim i mirë. Herën tjetër mendohuni dy herë para se të bëni një veprim.

Sabri Fejzullahu, fjalë të mëdha për Shyhrete Behlulin



Sabriu ka treguar vlerësimin që ka për Shyhreten. Dy emrat e njohur të estradës shqiptare, Sabri Fejzullahu dhe Shyhrete Behluli, vazhdojnë të sjellin këngë për fansat e tyre. Dyshja në fjalë të hënën pasdite e kanë kaluar bashkë në Brezovicë me më të dashurit e tyre, ndërsa kanë


realizuar edhe foto. Në një fotografi ku shfaqet krah Shyhretes, Sabriu e ka quajtur atë ikonë të muzikës shqiptare. “Me kolegen e miken time Shyhreten. Mbetë ikonë në zemrat e shqiptarëve dhe do të jesh përjetësisht e admiruar”, ka shkruar Fejzullahu në llogarinë e vet në “Instagram”.

Nicole Scherzinger dhe Thom Evans planifikojnë të bëhen prindër



Nicole dhe Thom duket se së shpejti do ta zgjerojnë familjen. Këngëtarja e njohur Nicole Scherzinger dhe i dashuri i saj Thom Evans duket se kanë planifikuar ta çojnë marrëdhënien e tyre në një tjetër nivel, shkruajnë mediat e huaja. Madje, sipas një burimi, ata

po planifikojnë edhe krijimin e familjes. “Askush nuk duhet të jetë i surprizuar nëse së shpejti shpërndahen lajmet për një shtatzëni të mundshme”, ka thënë ky burim. Më parë, gjatë këtij muaji, ata ishin parë në Portugali, ku edhe kishin festuar ditëlindjen e 45-të të Nicoles.



Dafina flet për Dj Geek: Ende jam e dashuruar

Dafina Zeqiri është ende e dashuruar me Dj Geek. Ka qenë vetë këngëtarja që e ka pohuar këtë fakt, ndonëse çifti i ka dhënë fund marrëdhënies pak kohë më parë. Dafina në emisionin “Në kurthin e Piter Pan” ka thënë se është shumë e dashuruar. “Jam ende pak e dashuruar se kam dashni shumë të madhe kështu që është ende këtu, brenda

meje”, ka pohuar Zeqiri, duke shtuar se në fakt do donte të mos dashuronte kaq fortë, pasi më parë ka qenë edhe më ndryshe, megjithatë mendon se tashmë nuk mund të ndryshojë më. Ajo ka thënë se dashuria është nga gjërat më të mëdha, bashkë me muzikën. Duket se ndarja mes çiftit nuk është përfundimtare e shumë shpejt do ta shohim sërish bashkë dyshen.

Modeluesja e njohur nuk e “duron” vapën



Ana Cheri ka dalë gjysmë e zhveshur në postimin e fundit. Ajo ka ndarë me ndjekësit një imazh të ri në llogarinë e vet në “Instagram”, ku shfaqet provokuese. Në këtë imazh, modeluesja amerikane kishte veshur vetëm në pjesën e poshtme bikini, kurse sipër

nuk mbante asgjë. Për ta mbuluar gjoksin, ajo kishte marrë një kapele në duar dhe po e mbante para, ndërsa nuk ishin të pakta komentet që arritën në adresë të tillë. Fotografi të tilla, Ana Cheri ka publikuar shumë shpesh në rrjete sociale, ku ndiqet nga miliona persona.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Marmarinos: Të gjithë do të krenohen me Kosovën

Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Christos Marmarinos, ka thënë se qëllimi i tij është që të gjithë shqiptarët e Kosovës të krenohen me Përfaqësuesen e basketbollit. “Synimi ynë është të luajmë për fitore. Fitorja është pjesë e rëndësishme për ne dhe ne duam ta bëjmë çdo kosovar në botë të krenohet me ekipin përfaqësues”, ka thënë Marmarinos



Marmarinos. Kosova në parakualifikimet evropiane për Botërorin 2023 ka mundur në shtëpi Islandën 80:78 dhe Luksemburgun në udhëtim 80:84. Në muajin nëntor, Dardanët janë mysafirë të Sllovakisë dhe Islandës. “Synimi ynë është të luajmë për fitore. Fitorja është pjesë e rëndësishme për ne dhe ne duam ta bëjmë çdo kosovar në botë të krenohet me ekipin përfaqësues. Në të njëjtën kohë, krijimi i një ‘mentaliteti të Basketbollit të Kosovës’ është po aq i rëndësishëm dhe fitorja në këtë sektor do ta frymëzojë dhe formojë gjeneratën e re të njerëzve të basketbollit në vend. Ky është qëllimi ynë më i madh dhe kjo do të jetë fitorja përfundimtare. Deri atëherë, ne do të luftojmë në çdo ndeshje për fitore”, ka deklaruar Marmarinos.

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kosova A te meshkujt do të grumbullohet në muajin gusht. Grumbullimi do të jetë disaditorë dhe me mundësi edhe një ndeshje miqësore. Ky grumbullim do të mbahet në Prishtinë dhe është i mirëseardhur për përzgjedhësin e Kosovës, Christos Marmarinos. “Është e rëndësishme që kampi të mbahet në gusht, kështu që ne ta shohim formën e lojtarëve tanë pas karantinës. Ne dëshirojmë të luajmë një rol

aktiv në jetën e tyre dhe të ndihmojmë në karrierën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Do të kemi disa ditë stërvitje, do të sigurohemi që të gjithë t’ia kujtojmë vetes strukturën e ekipit dhe duhet të funksionojmë për të ardhmen. Ne dëshirojmë që ata të ndihen si në shtëpi kur janë me ekipin përfaqësues”, është shprehur Marmarinos për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka folur edhe për rëndësinë që ky grumbullim ka për lojtarët e Kosovës. “Ne

presim ta vlerësojmë përparimin e lojtarëve. Ne do t’u japim mundësi të tjerëve që të jenë pjesë e ekipit përfaqësues. Ekipi nuk është një grup i mbyllur njerëzish, por një familje e gjerë që mund t’i përfshijë të gjithë ata që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime. Në

një mjedis më të qetë, lojtarët do ta kenë mundësinë të tregojnë vlerën e tyre dhe t’i njohin standardet e ekipit. Në këtë mënyrë, kur të vijë koha në nëntor ne do të zgjedhim mes lojtarëve që janë në formën më të mirë, pa përfshirë askënd nga procesi”, ka shtuar tutje

Hoti: Rashica është një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë të rinjtë shqiptarë



PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, e ka pritur në takim Milot Rashicën, një sportist i futbollit, Milot Rashica, i cili po qëndron për pushime në Kosovë. Hoti ka thënë se

Rashica është një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë të rinjtë shqiptarë. “Kënaqësi e veçantë ta takoj Milot Rashicën, një sportist i përmasave globale dhe shembull që duhet ndjekur nga të gjithë të rinjtë

shqiptarë. Milotit dhe kombëtares së Kosovës i uroj shumë fat në ndeshjen e ardhshme me Maqedoninë e Veriut dhe në kualifikime për Kampionatin Evropian”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”.

Zhegrova: Do ta dërgojmë Kosovën në Evropian

PRISHTINË, 14 KORRIK - Pas Valon Berishës e Milot Rashicës, Federatën e Futbollit të Kosovës e ka vizituar Edon Zhegrova. Ky i fundit po qëndron për në atdhe për pushime dhe me këtë rast ka vizituar edhe shtëpinë e futbollit, ku është pritur nga kryetari Agim Ademi, anëtari i KE-së, Xhelal Broja dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu. “Futbollisti i Baselit është shprehur i lumtur për rikthimin

